

**AKT-THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE "ALTEA GROUP" SH.P.K.**

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.131/2015 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar, themelohet Shoqeria "ALTEA GROUP" SH.P.K, me seli ne Elbasan, lagja "5 Maji", Pasuria me nr: 23/174 , zona kadastrale nr 8525, nga ortaku i vetem i kesaj Shoqerie Z. Edmond Shehu, i dtl 16/04/1960, lindur e banues ne Elbasan, shtetas shqiptar i pajisur me leternjoftimin me nr: 032043523, numer personal G00416071R, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar i cili:

**VENDOS**

Te krijoje nje Shoqeri Tregtare te emertuar "**ALTEA GROUP**" SH.P.K me kushtet e meposhtme:

**NENI 1**

Themeluesi ne cilesine e ortakut te vetem krijon shoqerine tregtare "**ALTEA GROUP**" SH.P.K me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

**NENI 2**

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

**NENI 3**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "**ALTEA GROUP**" SH.P.K emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj.  
Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar "**ALTEA GROUP**", SH.P.K, Elbasan, Albania.

**NENI 4**

Shoqeria e ka seline e saj ne **Elbasan, Lagja "5 Maji", Zona kadastrale nr: 8525, pasuria nr 23/174.**  
Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

**NENI 5**

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortaku i vetem vendos prishjen e saj.

**NENI 6**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :

**"Import eksport i bimeve medicinale dhe te gjitha mallrave industriale, konfeksione, pajisje, makineri. Shitje me shumice dhe pakice. Studime e projektme te punimeve pyjore, zbatime te punimeve pyjore, etj.**

  
Edmond Shehu

**Prodhim, blerje dhe tregtim brenda vendit dhe eksport i esencave bimore, vajrave eterovajore dhe te ngjashme me to."**

**NENI 7**

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

**NENI 8**

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte 100.000 (njqindmije) leke shqiptare.

Ortaku i vetem Z.Edmond Shehu zoteron 1 kuote me vlere 100.000 (njqindmije) leke ose 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

**NENI 9**

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

**NENI 10**

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga ortaku i vetem dhe administratori. Themeluesi me vendim te veçante do te emeroje dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijojë fondin rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultojë ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kalojë ortakut te vetem.

**NENI 11**

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te ortakut te vetem te saj.

Administrator i vetem i Shoqerise emerohet Z. Edmond Shehu, i dtl 16/04/1960, lindur e banues ne Elbasan, i pajisur me leternjofitim me nr: 032043523, numer personal G00416071R, me kohezgjatje te mandatit per 5 vjet.


Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

**NENI 12**

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

*Edmond Shehu*

**THEMELUESI I SHOQERISE TREGTARE**  
**“ALTEA GROUP” SH.P.K.**  
**Edmond Shehu** ✕



**Elbasan me 15 shkurt 2022**